

## FJALA E DEPUTETIT FATMIR MEDIU

E ENJTE 30 QERSHOR 2022

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke vlerësuar shqetësimin e fundit të koleges Gjylameti për gjendjen e jashtëzakonshme, mendoj se është koha që jo vetëm qeveria, por edhe parlamenti ta shikojë me realitet situatën në të cilën ndodhemi. Kriza nuk do të jetë as momentale dhe as e shkurtër, e cila do të kapë shumë sektorë të ekonomisë dhe si e tillë është e domosdoshme që qasja e ekonomisë të mos jetë spontane apo selektive. Edhe në aktin normativ jeni përqendruar në një fushë të caktuar, për shkak të një interesi të caktuar ekonomik, të cilin nuk mund ta mohoj.

Është e domosdoshme ta mbështesim biznesin, por ajo që mund të bëjë më mirë qeveria në këtë situatë është që të ketë një qasje në tërësi për çështjet ekonomike, për problemet që kanë të bëjnë me të gjithë ekonominë shqiptare. Ndoshta, për të mos pasur një proces selektiv, qoftë të kompanive, por edhe të atyre kompanive që kanë punë publike në sektor të caktuar, do të ishte më mirë të bëhej një subvencionim të lëndëve të para, sepse kjo do të ndikonte në mënyrë të padiskutueshme jo vetëm në mbarëvajtjen e kontratave publike me këto kompani, por edhe në mbarëvajtjen e biznesit, sepse në fund ata që do të paguajnë më shtrenjtë do të jenë qytetarët shqiptarë si në pikëpamje të taksave, ashtu edhe në pikëpamje të çmimeve.

Të nderuar deputetë,

Duke parë këtë situatë të jashtëzakonshme, mendoj se duhet të shikojmë një këndvështrim tjetër për ekonominë, që nuk është vetëm ekonomi. Ekonomia sot ka të bëjë shumë me sigurinë. Po shikojmë që problemet e sigurisë ndikojnë tërësisht në problemet ekonomike të vendeve, në problemet e furnizimit, në çmimet e lëndëve të para, në çmimet e produkteve, në split chain e të tjera, ndaj parlamenti dhe qeveria duhet të shikojnë hapat që duhen ndjekur në përballimin e këtyre situatave. Kjo më çon tek ajo që po ndodh ditët e fundit, ndaj dua të vlerësoj atë që u bë në Madrid, në Samitin e NATO-s. Dua ta them hapur që shqiptarët duhet të

jenë krenarë dhe të vlerësojnë më shumë se kurrë, edhe në dokumentin e miratuar në Samitin e NATO-s, në Madrid, faktin që Shqipëria është vend anëtar i NATO-s.

Ndaj, gjej rastin të falënderoj të gjithë ato burra dhe gra me uniformë që kanë kontribuar, të gjithë ata që punuan për anëtarësimin e Shqipërisë në NATO dhe nuk e panë anëtarësimin si një foto opportunity, por si përgjegjësi për sigurinë kombëtare në partneritet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Arritja e parë, pranimi i Suedisë dhe i Finlandës në NATO, ishte një hap për të garantuar një Europë më të sigurt. Ne dhe dokumentin strategjik të NATO-s duhet ta lexojmë me vëmendje të madhe, sepse ka të bëjë me ne, jo vetëm thjesht se jemi vend anëtar i NATO-s, por sepse efektin në pikëpamje të financave të zhvillimit të politikave ekonomike dhe të sigurisë edhe vendin tonë.

Është e përcaktuar qartë se Rusia është kërcënimi më i madh i NATO-s, mjetet dhe mënyrat që ajo përdor për të ndërhyrë janë tërësisht në kundërshtim me ligjet ndërkombëtare. Ajo që po ndodh në Ukrainë është një akt agresioni ushtarak, me qëllime të qarta të uzurpimit dhe të shkatërrimit të një vendi, thjeshtë dhe vetëm për faktin se duan dhe mbrojnë lirinë dhe perspektivën e tyre europiane. Po a jemi ne larg këtyre situatave? Mjafton të lexojmë një pikë tjetër të dokumentit strategjik të NATO-s, që flet për Ballkanin, i cili ngre shqetësimin për influencën e Rusisë dhe të Kinës, këtu vjen edhe momenti ekonomik për ta shqyrtuar të gjithë së bashku. Çdo marrëdhënie politike, çdo marrëdhënie ekonomike, të nderuar kolegë deputetë, duhet të ketë si primar interesin tonë kombëtar dhe sigurinë, sidomos frenimin e penetrimit të Rusisë dhe të Kinës në rajonin tonë.

Pra, si vend anëtar i NATO-s kemi tre elemente të domosdoshme që duhet ta shikojmë marrëdhënien tonë: E para, duhet të jemi kontribuues dhe të arrijmë ato nivele që kërkohen. E dyta, nga pikëpamja dhe komponenti politik për të luajtur një rol të rëndësishëm për sa i përket situatës dhe interesit të shqiptarëve në rajon dhe interesit tonë kombëtar dhe në mënyrë të padiskutueshme, ajo që është e rëndësishme, edhe si një faktor në stabilitetin e rajonit të Ballkanit, që çdo nismë që duhet të ndërmarrim në këtë pikëpamje, qoftë “Ballkani i hapur”, qoftë Procesi i Berlinit apo iniciativa të tjera, duhet patjetër të kenë të gjithë instrumentet që të

frenojmë implikimet e ndikimit dhe ndërhyrjet e Rosisë dhe Kinës në rajonin tonë. Në këto situata janë përcaktuar qartë edhe risqet që ka Ballkani.

Po e them edhe një herë, ndoshta është jashtë linjës së aktit normativ, por që ka të bëjë me zhvillimin tonë si vend dhe si rajon, që efektton në mënyrë të drejtpërdrejtë ekonominë. Ndaj, mendoj se krahas këtyre debateve që bëjmë për çështjet ekonomike, ka ardhur koha që Kuvendi i Shqipërisë të jetë më i angazhuar për të kuptuar, e para, strategjinë e sigurisë tonë kombëtare, strategjinë ushtarake, se si duhet t'i përshtatimi në këtë konjunkturë të re dhe të mos e lëmë thjesht si një domen i qeverisë, duke mos diskutuar aspak për interesin tonë primar.

Më tej dua të shkoj në një moment tjetër, kërkoj që parlamenti ta vlerësojë në maksimumin e tij, te fakti se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dy ditë më parë kanë vendosur sanksione për disa kompani kineze, të cilat kanë mbështetur Rusinë dhe kanë cenuar sanksionet e vendosura në Rusi. Por as ne nuk jemi të imunizuar. Pikërisht kompani ruse, që veprojnë në Shqipëri, mund të jenë pjesë e një analize për interesin e sigurisë kombëtare, sa e cenojnë sigurinë tonë kombëtare, kanë qenë të lidhura me këto kompani që kanë shkelur sanksionet. Pushtimi i Ukrainës po qartëson një aleancë dhe një pol të ri gjeopolitik, atë të Rosisë dhe Kinës. Përpara pushtimit të Ukrainës dy qeveritë lëshuan një deklaratë se nuk ka asnjë kufi për miqësinë ndërmjet Moskës dhe Pekinit dhe nuk ka zona të ndaluara bashkëpunimi.

Pas vendosjes së sanksioneve ndaj Rosisë ka një forcim të lidhjeve ekonomike mes Rosisë dhe Kinës me firmat Kineze, në kundërshtim me sanksionet, të cilat i kemi mbështetur edhe ne, për të zëvendësuar firmat ndërkombëtare që tërhiqen nga Rusia. Këtë javë qeveria e Shteteve të Bashkuara vendosi 5 firma të Republikës së Kinës në listën e zezë të kontrollit të eksportit për ofrimin e mbështetjeve teknologjike për Rusinë. Ndaj i takon qeverisë, por edhe këtij Kuvendi, që të flasë qartë dhe hapur, që asnjë nga këto kompani të mos ushtrojë aktivitet ekonomik në Shqipëri për sa kohë bien ndesh me atë që ne bëhemi dhe jemi pjesë e Aleancës së Atlantikut të Veriut, strategjisë dhe qëllimeve tona të sigurisë kombëtare.

Edhe si anëtar i Aleancës Ndërparlamentare për Kinën kërkoj që Kuvendi i Shqipërisë të marrë më shumë rol për të vlerësuar sigurinë ekonomike në vendin tonë, që ka të bëjë me sigurinë

kombëtare, jo vetëm nga pikëpamja e ligjeve, se sa taksa mbledhim, sa kontrata publike kemi, si zhvillohet biznesi, po kush dhe si zhvillohen aktivitetet në ekonominë tonë, sidomos në këndvështrimin rajonal të çështjes. Faleminderit!